

WWII-MONUMENTSEE

ASSESSMENT OF POST-WORLD WAR II MONUMENTS IN SOUTH EAST EUROPE IN ORDER
TO DEVELOP A NEW REGIONAL TOURISM PRODUCT/ CULTURAL ROUTE



**Vlerësimi i monumenteve të kushtuara Luftës së Dytë
Botërore në Shqipëri për formimin e prodhimit të ri turistik
rajonar/rutës kulturore në Evropën Juglindore**



“Vlerësimi i monumenteve të kushtuara Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri për formimin e prodhimit të ri turistik rajonal/rutës kulturore në Evropën Juglindore” u realizua në kuadër të projektit “WWII-MONUMENTSEE – Vlerësimi i monumenteve të kushtuara Luftës së Dytë Botërore në Evropën Juglindore për të zhvilluar prodhimin e ri turistik rajonal/rutën kulturore”.

“WWII-MONUMENTSEE – Vlerësimi i monumenteve të kushtuara Luftës së Dytë Botërore në Evropën Juglindore për të zhvilluar prodhimin e ri turistik rajonal/rutën kulturore” që u zbatua nga EXPEDITIO u financua me mjete të siguruar përmes Projektit për zhvillimin e turizmit të Këshillit për bashkëpunim rajonal (Regional Cooperation Council - RCC). Ky projekt i Këshillit për bashkëpunim rajonal financohet nga Bashkimi Evropian, dhe zbatimi i tij synon që të kontribuojë rritjes dhe konkurrueshmërisë në gjashtë ekonomi të Ballkanit Perëndimor duke ndihmuar zhvillimin dhe promovimin e ofertës së përbashkët rajonale kulturore dhe aventuriste në turizëm. Ky vlerësim është një nga rezultatet e projektit “WWII-MONUMENTSEE – Vlerësimi i monumenteve të kushtuara Luftës së Dytë Botërore në Evropën Juglindore për të zhvilluar prodhimin e ri turistik rajonal/rutën kulturore”.

Redaktorët/Botuesit:

EXPEDITIO



Autori i “Vlerësimit të monumenteve të kushtuara Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri për formimin e prodhimit të ri turistik rajonal/rutës kulturore në Evropën Juglindore”

Helidon Sokoli, Sabrina Kuçi, Petrit Bilali



*Provided by the RCC Tourism Development and
Promotion Project's Grant Programme*

The Project is funded

by the European Union

Përmbajtje

Hyrje.....	1
Përmbledhje e shkurtër.....	6
Përshkrimi i gjendjes së përgjithshme të monumenteve të Luftës së Dytë Botërore.....	8
Nje list e zgjeruar e monumenteve.....	16
Pershkrimi i rrugeve kulturore potenciale te monumenteve te luftes se dyte boterore	27
Shembujt e analizës së detajuar të monumenteve të përzgjedhura.....	32
Nene Shqiperia.....	33
5 Heronjte e Vigut.....	44

Hyrje

Projekti **“WWII-MONUMENTSEE - Vlerësimi i monumenteve të kushtuara Luftës së Dytë Botërore në Evropën Juglindore për të zhvilluar prodhimin e ri turistik rajonal/rutën kulturore”** (më tutje në tekst WWII-MONUMENTSEE) që u zbatua nga EXPEDITIO u financua me mjete të siguruara përmes Projektit për zhvillimin e turizmit të Këshillit për bashkëpunim rajonal (Regional Cooperation Council - RCC). Ky projekt i Këshillit për bashkëpunim rajonal financohet nga Bashkimi Evropian, dhe zbatimi i tij synon që të kontribuojë rritjes dhe konkurrueshmërisë në gjashtë ekonomi të Ballkanit Perëndimor duke ndihmuar zhvillimin dhe promovimin e ofertës së përbashkët rajonale kulturore dhe aventuriste në turizëm. Ky vlerësim është një nga rezultatet e projektit WWII-MONUMENTSEE.

Projekti WWII-MONUMENTSEE është zbatuar në periudhën nëntor 2018 – qershor 2019

Zona e zbatimit të projektit: Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, Kosova*, Mali i Zi, Serbia dhe Maqedonia e Veriut.

Monumentet e kushtuara Luftës së Dytë Botërore në zonën e Evropës Juglindore paraqesin potencial të konsiderueshëm për zhvillim të rutës rajonale kulturore turistike. Këto monumente, të cilët në një numër të lartë janë krijuar gjatë periudhës pas Luftës së Dytë Botërore në gjithë territorin e ish Jugosllavisë dhe të Shqipërisë pikësëpari janë memorialët e luftës antifashiste, por edhe më shumë se aq, kurse shumë prej tyre e kanë një vlerë të jashtëzakonshme artistike. Pas ndryshimeve që kanë ndodhur gjatë viteve të 90-ta të shekullit XX në zonën e Evropës Juglindore vjen deri tek mënjanimi i këtyre monumenteve, gjë që ka çuar deri tek lënia pas dore për shkak të mos mirëmbajtjes së tyre, dhe në disa raste edhe deri tek shkatërrimi ose rrënimi i plotë i tyre. Interesimi i përtëritur për këto monumente ia fillon në gjysmën e dytë të dekadës së parë të shekullit XXI, që nga viti 2006, si nga artistët dhe studiuesit e huaj, ashtu edhe nga ata nga hapësirat e Evropës Juglindore. Po ashtu, rëndësia e monumenteve të kushtuara Luftës së Dytë Botërore përsëri ia ka filluar të zbulohet edhe në dritën e turizmit. Megjithatë, të gjitha këto nisma dhe aktivitete janë sporadike, shpesh vijnë nga vendet tjera, jo nga ato ku monumentet ndodhen, dhe nuk janë të sinkronizuara, ashtu që nuk ekziston një prodhim turistik i veçantë, as në kuadër të vendeve individuale, as në kuadër të rajonit të Evropës Juglindore. Gjithashtu, nuk ekzistojnë informacionet mbi këto

*Kjo shenjë nuk paragjykon qëndrimet mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244/1999 të Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara dhe me Mendimin e Gjykatës ndërkombëtare të drejtësisë mbi deklaratën mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

monumente të bashkuara në një vend, por as analiza e detajuar e vlerës, gjendjes, si dhe potencialit të tyre për zhvillimin e rutave turistike.

Objektivi specifik i projektit WWII-MONUMENTSEE është zbatimi i fazës fillestare të zhvillimit të prodhimit të ri rajonal turistik/rutës kulturore – monumentet e kushtuara Luftës së Dytë Botërore – në zonën e Evropës Juglindore, përmes hartimit të vlerësimit. **Objektivat e përgjithshme** të projektit janë: zhvillimi i prodhimit të ri rajonal turistik/rutës kulturore – monumentet e kushtuara Luftës së Dytë Botërore – në zonën e Evropës Juglindore; avancimi (i punësimit dhe i qëndrueshmërisë) së turizmit rajonal në zonën e Evropës Juglindore, përmes zhvillimit të prodhimit të ri rajonal turistik/rutës kulturore; kontributi tek rritja e ekonomike e rajonit të Evropës Juglindore përmes fuqizimit të turizmit rajonal dhe rutave kulturore.

Aktivitetet që janë realizuar gjatë projektit WWII-MONUMENTSEE kanë përfshirë: formimin e ekipit rajonal të ekspertëve dhe përkufizimi i konceptit dhe metodologjisë së punës; studimi dhe mbledhja e të dhënave nga 6 ekonomitë e Evropës Juglindore dhe hartimi i 6 “Vlerësimeve të monumenteve të kushtuar Luftës së Dytë Botërore për formimin e prodhimit të ri rajonal turistik/rutës kulturore në zonën e Evropës Juglindore” individuale nga studiuesit e përzgjedhur; organizimi i punëtorisë rajonale të ekspertëve; hartimi i “Vlerësimit të monumenteve të kushtuara Luftës së Dytë Botërore në Evropën Juglindore për formimin e prodhimit të ri turistik rajonal/rutës kulturore në Evropën Juglindore” dhe shpërndarja e rezultateve të projektit të gjithë palëve të interesuara.

Hartimi i 6 **“Vlerësimeve të monumenteve të kushtuar Luftës së Dytë Botërore për formimin e prodhimit të ri rajonal turistik/rutës kulturore në zonën e Evropës Juglindore” individuale** ka përfshirë këto aktivitete dhe segmente:

- **Shqyrtimi i gjendjes së përgjithshme të trashëgimisë së monumenteve të Luftës së Dytë Botërore** që është dashtë të jap një pamje të përgjithshme mbi trajtimin e këtij segmenti të trashëgimisë kulturore në 6 ekonomi, duke përfshirë: kornizën ligjore e cila e rregullon mbrojtjen, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e monumenteve të Luftës së Dytë Botërore; institucionet/aktorët kryesorë përgjegjës për mbrojtjen, menaxhimin, mirëmbajtjen dhe promovimin e monumenteve të Luftës së Dytë Botërore; nismat e deritanishme (projektet artistike, studimet, promovimet, aktivizmin...); shqyrtimi i palëve të interesuara/stejkholderave dhe vëzhgimi i përgjithshëm i gjendjes së përgjithshme të monumenteve të Luftës së Dytë Botërore: mbrojtja, mirëmbajtja, përdorimi, menaxhimi dhe valorizimi turistik.
- **Analiza e listës së zgjeruar të monumenteve** është bërë në bazë të listave zyrtare të monumenteve të mbrojtura të Luftës së Dytë Botërore në ekonomitë e caktuara si dhe në bazë të Listës së siteve të propozuara për rutat e monumenteve të Luftës së Dytë Botërore që është dorëzuar nga Këshilli rajonal për bashkëpunim, dhe që ka përfshirë

40 monumente tashmë të përzgjedhur që është dashtë gjithsesi të përfshihen.¹ Analiza e monumenteve është bërë në bazë të kriterëve të akorduara².

¹ Lista e dorëzuar nga RCC ka përfshirë 40 monumente:

- *Shqipëria*: Shkodër, Kamëz, Nënë Tereza (Tiranë), Pezë e Vogël, Bërzhitë, Elbasan, Pishkash
- *Bosnje-Hercegovina*: Parku memorial Vraca (Sarajevo), Monumenti Vogošća, Muzeu memorial i betejës së Neretves (Jablanica), Varrezat e partizaneve në Mostar, Monumenti Sutjeska (Tjentište), Zenica, Novi Travnik, Jajce, Sanski Most, Kozara (afër Prijedorit), Banja Luka
- *Kosova*: Prishtinë (qendër), Monumenti në Brezovicë, Mitrovica veriore, Varrezat e martirëve partizanë, Matiçani, Prishtinë
- *Mali i Zi*: Siti memorial Dola, Monumenti në Nikšić, Monumenti në Barutanë (Podgoricë), Muzeu memorial në Kolašin, Monumenti në Berane
- *Serbi*: Varrezat hebrej (Beograd), Parku memorial Jajinci, Monumenti Kosmaj, Siti memorial Čačak, Siti memorial Kadinjača (afër Užices), Parku memorial Bubanj (Nish), Parku memorial Šumarice (Kragujevac), Monumenti i revolucionit (Leskovac)
- *Republika e Maqedonisë së Veriut*: Monumenti i tërmetit të Shkupit, Eshtërorja Kičevo, Makedonium (Krushevo), Monumenti në Prilep, Eshtërorja Veles

² Kriteret ishin këto:

- **CILËSITË VIZUALE DHE ESTETIKE**: forma abstrakte; format që i kundërvihen konventës së monumenteve tradicionale; format që fshehin domethënien simbolike më të thellë dhe/ose vlerën universale pas formës së vetë abstrakte; që janë krijuar nga artistët e famshëm, të njohur ose të përsosur të asaj epoke
- **RËNDËSIA HISTORIKE DHE KULTURORE**: monumentet që flasin për ngjarje universale të përballimit të vështirësive dhe mposhtjes së armikut; të fokusuar tek niveli njerëzor/fitorja ose tragjedia e civileve; përshkruajnë ngjarjet interesante që janë pak të njohura jashtë zonës së caktuar
- **BUKURIA NATYRORE**: të jepet përparësi monumenteve që ndodhen në ambientin jashtëzakonisht të bukur natyror; të jepet përparësi monumenteve që ndodhen në afërsi të parqeve kombëtare, lumenjve piktoreske, etj.; të jepet përparësi monumenteve që ndodhen në vende të qeta larg nga turmat tjera turistike
- **TURIZMI**: promovojnë turizmin në zona jo mjaft të zhvilluara
- **GJENDJA**: në zona ku nuk ka tensione ose dhunë politike/fetare/etnike; në zona të cilat nuk janë të rrezikuara nga minat dhe mjetet tjera të rrezikshme; zonat që janë relativisht të paprekura dhe përmes të cilave nuk është rrezik të kalohet; monumentet që janë në gjendje racionalisht të rregullt dhe të ruajtur; që nuk janë shumë të shkatërruara ose të vandalizuara

- **Propozimi i rutave potenciale** për çdo ekonomi është dhënë në bazë të listës së gjerë të monumenteve. Janë njohur mundësitë për nivelet e ndryshme të rutave: ruta/t rajonale, rutat në kuadër të vendeve, rutat lokale. Gjithashtu, janë shqyrtuar temat e ndryshme, midis të cilave: vlera artistike, autori/-ët, personat e njohura, madhësia, filming, mountaineering, antifashizmi etj. Përveç këtyre, janë shqyrtuar edhe mundësitë për përfshirjen e monumenteve në rutat tashmë ekzistuese ose në ofertën turistike fqinje.
- **Analiza e detajuar e monumenteve të përzgjedhura** është bërë në bazë të analizave të zbatuara për ka 10-12 monumente në çdo ekonomi që ndodhshin në Listën e dorëzuar nga RCC-ja si dhe në listën e zgjeruar të monumenteve sipas zgjedhjes së studiuesve. Analiza e detajuar është bërë në bazë të formularit i cili është përcaktuar nga ekipi i ekspertëve rajonalë.
- **Lista e literaturës dhe shtojcat** janë shoqëruar çdo vlerësimit, dhe përfshijnë, midis tjerash, edhe: listën zyrtare të monumenteve të mbrojtura të Luftës së Dytë Botërore; listën e palëve të interesuara/stejkholderave; materialin shtesë të rëndësishëm për shqyrtim të gjendjes së përgjithshme të trashëgimisë së monumenteve të Luftës së Dytë Botërore.

Në bazë të Vlerësimeve individuale në 6 ekonomitë është punuar “**Vlerësimi i monumenteve të kushtuara Luftës së Dytë Botërore për formimin e prodhimit të ri rajonal turistik/rutës kulturore në Evropën Juglindore**” i përbashkët rajonal.

“**Vlerësimi i monumenteve të kushtuara Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri për formimin e prodhimit të ri turistik rajonal/rutës kulturore në Evropën Juglindore**” është një nga 6 vlerësime individuale të zbatuara në kuadër të projektit. Autorja e këtij Vlerësimi është Helidon Sokoli, Sabrina Kuçi, Petrit Bilali.

Në dokument është dhënë **ekstrakti nga Vlerësimi i monumenteve të kushtuara Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri** që përfshin të dhënat, analizat dhe propozimet kyçe, ndërsa tërë materiali me dokumentacionin e bashkëlidhur i është dorëzuar RCC-së.

-
- QASSHMËRIA: ndodhen në afërsi racionale të rrugëve parësore ose autostradave, ndodhen në afërsi racionale të shërbimeve turistike (akomodimi, ushqimi, karburanti, etj.); mund t'i gjejnë turistët të cilët nuk e njohin zonën; plotësisht të qasshëm gjatë gati gjithë vitit, përveç në raste të kushteve ekstreme të motit.

WWII-MONUMENTΣΣΣ

Përmbledhje e shkurtër

Ishte një eksperience e veçantë ndjekja e këtij projekti i cili na hapi një dritare të re komunikimi me botën e artit dhe interpretimin e tij gjatë periudhës së Realizmit Socialist, e parë kjo përmes ndërthurjes së tre disiplinave (artit, arkitektures dhe historisë) të cilat janë edhe specialitetet tona si grup pune¹.

Projekti në fjalë na krijoi një hapësirë dhe një fushepamje me të cilën nuk ishim njohur me parë, si në kontekstin historik, artistik dhe urbanistik. Kjo për faktin se synuam të ndertonin këtë projekt mbi bazë të shëndetshme, duke kontaktuar personat që kishin kontribute historike në ruajtjen dhe muzealizimin e teksteve që flisnin mbi LANÇ, si z.Mit'hat Dibra (ish drejtor i Muzeut Historik Shkoder), z.Zamir Llazani (kryetar i shoqatës LANÇ) dhe anëtarët e tjerë të kësaj shoqate e deri ekspertet urbanist të kohës që mundësuan vendosjen e veprave të asaj kohe si z.Ruzhdi Dibra (Përgjegjës i Zyres së Urbanistikës, pranë ish Komitetit Ekzekutiv Shkoder).

Një vend të rëndësishëm në këtë projekt zënë ato që i ndertuan veprat me duart e tyre, autorët si z.Thoma Thomai dhe z.Hektor Dule, të cilëve në i kushtuam edhe rruget turistike që janë pjesë integrale e projektit duke na informuar për impenjimin maksimal jo vetëm të autoreve në fjalë por edhe të gjitha mekanizmave të pushtetit të asaj kohe, qoftë ai lokal ose qendror. Veprat e tyre reflektojnë për nivelin e lartë kulturor dhe arsimor që skulptoret e kohës kishin, por gjithashtu na japin një tablo të plote mbi elementet karakteristike të skulpturës. Vëmë re kontrastin mes dinamikës së lëvizjes dhe plasticitetit të veprave, mënyrën e kompozimit si dhe ruajtjen e raporteve sa më reale.

Takimi me personazhe historik të asaj kohe, që kanë kontribute reale në ndërtimin e këtyre veprave na krijoi një ide me të saktë të asaj se çfarë synonte arti i Realizmit Socialist në përgjithësi dhe memorialet e të rinëve të Luftës së Dytë Botërore në veçanti. E themi me plote gojë që vlerat e prodhuara mbi bazën e ngjarjeve të Luftës së Dytë Botërore, janë vlera të patjetersueshme kombëtare, aq sa ne, që jemi pjesë e këtij realiteti, kemi ngjellur të impresionuar nga niveli i punimit, volumi dhe impenjimi për të ndërtuar këto monumente. Në këtë kuader impakti tek të huajtë që kanë vizituar dhe do të vizitojnë vendin tonë, do të jetë i padiskutueshëm, duke e kthyer Shqipërinë në një atraksion turistikohistorik dhe duke qënë një ndër arsye të duhet të vizitohet vendi ynë.

Kur themi "vlera" bëhet fjalë për hapat e parë të skulpturës dhe artit monumental Shqiptar dhe për autor që tashmë janë në historinë e artit shqiptar dhe me gjere. Jemi të lumtur në na u dha mundësia që të prezantojmë dimensionet e autoreve dhe artit monumental shqiptar, të cilët gjatë njohjes me projektin na ofrojnë gjuhë shprehëse artistike, teknika dhe materiale nga më të larmishmet.

Ajo që gjithnjë ka qënë një disfavor për monumentet e kësaj periudhe ishte fakti e një mungese apo një vakum ligjor në lidhje me mbrojtjen dhe mostjetersimin e tyre. Përgjatë viteve ato kanë qënë pjesë e sulmeve të ndryshme politike duke bërë që një pjesë e mirë e tyre të zhduken,

tjetersohen apo te humbin identitetin e tyre. Injoiranca artistike e popullit ne kete aspekt , eshte reflektuar ne mos reagimin e tyre kur nje pjesez e historise eshte zhdukur. Kjo ishte nje fakt i ndeshur thua jse ne te gjithë monumentet e vizituara² duke na lene te kuptojme se pas viteve '90 nuk ka pas interes nga shteti per keto vepra.

Ne perfundim te kesaj faze na mbetet vetem te ecim ne kete rruge te nisur per promovimin e ketyre monumenteve dhe veprave arti, lobimin fuqishem per krijimin e nje ligji per mbrojtjen dhe restaurimin e tyre si dhe nxitja e mases t'i shofin kete vepra si pjese te kultures, historise dhe trashegimise kulturore te vendit tone.

¹Grupi i punes Helidon Sokoli (historian/ arkeolog), Sabrina Kuçi (arkitekthe/urbaniste) dhe Petrit Bilali (skulptor).

² Falenderojme z.Rubin Mandija, z.Fadil Fyshku, z.Gent Faja per asistencen e ofruar pergjate projektit.

Përshkrimi i gjendjes së përgjithshme të monumenteve të Luftës së Dytë Botërore

Monumentet janë pjese e memories kolektive dhe si të tilla percjellin jo thjesht vlerat artistike të kohës, por edhe vlera historike.

Ato percojnë në ditët e sotme ndodhite apo ngjarjet e një periudhe të caktuar, duke na dhënë në mënyrë indirekte një rrjedh logjike të ngjarjeve të ndodhura në vend. Historia e popullit tone është e pasur me figura të shquara, të cilët kanë lënë gjurmën e tyre në të, duke shkruar historinë dhe jo vetëm. Ato na bëjnë të ndjehemi krenar për atë kulturë, trashëgimi, art, dhe histori që kemi.

Si pjesë e kësaj historie, meqë fokusi është Lufta e Dytë Botërore dhe monumentet e ndërtuar lidhur ngushtesisht me këtë histori, në kemi bërë një studim të përgjithshëm të këtyre lapidarëve, memorialeve apo relieveve të kësaj periudhe.

Duket sikur zhvillimit teknologjik, standarti ekonomik, apo formimi profesional i asaj periudhe na jep vepra në pamje të pare me karakteristika të njëjta si nga ana strukturore, ashtu edhe historike. Por duke e parë pak më në brendi dallojmë ndryshime që vëjnë për tu theksuar dhe evidencuar, duke na bërë kështu të veçantë për nga stili, origjinaliteti apo historia.

Lapidaret e post Luftës së Dytë Botërore përjetuan rrugetimin e tyre që nga vendosja e gjer me sot. Momenti i pare ishte moment lavdië jo vetëm për ndërtuesit e tyre, por edhe për komunitetin që ngjarjet e luftës i kishte akoma të fresketa. Për zonë të ndryshme në Shqipëri ishte një revolucion kulturor. Këto vepra në momente të caktuara kishin aq shumë pesha ideologjike saqë mund të krahasoheshin me vepra madhore të partise si urat, uzinat, fabrikat etj. Kjo për faktin sepse peisazhi urban të qytetit dhe fshatrave i mungonte gjuha e arteve figurative, ose në rastin më të mirë sapo kishte filluar të ceket nga pionerët e skulpturës si Odise Paskali, Janaq Paço, Andrea Mano etj. Disa nga lapidarët ishin të ndërtuar me nivel më të ulët artistik nga entet shtetërore lokale. Ato ishin të ndërtuara thjesht, në mënyrë lineare në beton, pa koncepte artistike të integruara, ose vepra arti të gjuheve të ndryshme si relieve, skulptura mozaiku etj. Sot këto memoriale mund të duken ndonjëherë edhe si objekte të pavlera, por për kohën që u ndërtuan, për komunitetin ishin një arritje shumë e madhe.

Periudha që pasoi ishte një dëshmi e transformimit të memorialeve të luftës në memoriale të punës dhe ndërtimit të socializimit. Këto të fundit ja moren sado pak shkelqimin dhe lavdinë memorialeve të luftës Nacional-Çlirimtare. Skulptura dhe veprat e artit publik nuk ishin më lajmi sensacional që ekzaltonte publikun dhe masat.

Gjithsesi rastet e ndertimit të memorialeve dhe veprave publike mbi LANÇ, vazhduan pamvaresisht se në numër me të reduktuar deri në kufirin e viteve '90.

Zhvillime cilesore dhe gjini të reja të artit figurativ publik, solli plejada e dyte e artisteve të shkolluar në shkollat lindore si Moske, Prage etj. Prurja e re e kesaj plejade ishte gjinia e relievit e sjelle në shkollen shqiptare nga skulptore si Thoma Thomai, Kristaq Rama , Shaban Haderi , Hektor Dule etj.

Pas viteve 90 me renien e murit të Berlinit, veprat publike të Luftes Nacional Çlirimtare njohen periudhe e tyre me të veshtire.

Ato u konceptuan nga masat dhe komunitetet si produkt i makinerise propogandistike të komunizmit, duke u bere shpesh here viktima e turmave dhe objekt i shfryrjes se mllefrit antikomunist. Pati nga ato monumente që u demtuan pjeserisht, të tjere pesuan shkalle me të larte demtimi , e gjer tek ato që u shemben fare.

Vlen të permenden ketu edhe ato komunitete që i ruajten ato si vlera.

Periudha e viteve 2000 u pasua nga një indiferentizem i theksuar kundrejt ketyre veprave, ndersa periudha që në po jetojme aktualisht mund të quhet si një periudhe rinteresimi, kjo sepse një pjese e madhe e komuniteteve per arsye të moshes nuk i sheh me ato si objekte të mekanizmit ideologjik, por si shtresezime kulturore. Riinteresimi ndaj objekteve të LANÇ ka edhe dy arsye të tjera:

1. Niveli i dobet i disa veprave publike të vendosura pas viteve '90, gje që ben të rivleresohet niveli artistik i ketyre veprave.
2. Interesim i vecante nga ana e turisteve, sidomos të atyre që vijne nga perendimi, pasi kjo gjuhe arti dhe shprehje per ta është dicka e re, per arsye të ndryshimit të shkollës se skulptures, mes perendimit dhe lindjes, gjithashtu edhe si produkt i një vije ideologjike, që per ta shpesh here është gati i panjohur.

Shqiperia në kontekstin historik të Luftes se II Boterore

Lufta Antifashiste Nacional-Çlirimtare e popullit shqiptar e cila u zhvillua në rrethanat e Luftës së Dytë Botërore drejtohej kundër dy fuqive agresore më të mëdha të kohës, Italisë fashiste dhe Gjermanisë naziste.

Gjatë viteve, është folur e shkruar shumë, për këtë ngjarje të madhe të historisë së Shqipërisë. Në fakt, diskutimi mbi rëndësinë e LANÇ-it dhe mbi vendin që zë ajo në historinë e popullit shqiptar është shumë i gjerë. Ai doli para opinionit publik shqiptar që në vitet e Luftës së Dytë Botërore. Në atë kohë ishte e kuptueshme dhe e justifikueshme që të mos kishte një vlerësim unik nga opinioni i brendshëm dhe ai ndërkombëtar. Bota atëherë ishte ndarë në dy kampe të

kundërta nga njera anë blloku fashist, i kryesuar nga Gjermania, Italia dhe Japonia, dhe nga ana tjetër Koalicioni Antifashist i kryesuar nga Britania e Madhe, Bashkimi Sovjetik dhe SHBA. Përgjithësisht tri ishin rrymat politike në vend në këtë periudhë. Së pari, ishin nacionalistët liberalë, në radhët e të cilëve bënin pjesë intelektualë të formuar me kulturë perëndimore e krahas tyre dhe luftëtarë të njohur antifashistë. Grupimin e dytë politik e përbënin partizanët zogistë që nuk pranuan të hynin në shërbim të administratës kuislinge. Forcën e tretë politike antifashiste e përbënin komunistët.

Shqipëria ishte ndër viktimat e para të agresionit fashist, por dhe ndër vendet e para që u ngrit me armë kundër tij duke dëshmuar kështu se shqiptarët ishin një popull liridashës. Pavarësisht nga divergjencat politike, ideologjike dhe taktike që kishin midis tyre, komunistët tërhoqën shpejt vëmendjen e opinionit publik dhe hynë në skenën politike të vendit si një forcë e konsiderueshme antifashiste. Zgjerimi i rezistencës antifashiste dhe ashpërsimi mbi këtë bazë i situatës politike në vend, nxori dobësinë dhe paaftësinë e rrymave të tjera politike. Në këto kushte inisiativën e morën komunistët, pjesa më e madhe e tyre moshe e re dhe të lidhur ngusht me organizatat dhe Partitë simotra të Lindjes, të cilët lanë mënjanë mosmarrëveshjet dhe, në nëntorin e vitit 1941, u bashkuan duke themeluar Partinë Komuniste të Shqipërisë. Partite e tjera nacionaliste ngelen të kufizuara si në territor ashtu dhe mbështetje popullore. Që nga Konferenca e Pezës në shtator 1942, barrën e drejtimit të luftës e mori Fronti Nacional-çlirimtar. Si rezultat i luftës që po zhvillonte Fronti Nacional-Çlirimtar, në dhjetor 1942 tre Fuqitë e Mëdha aleate, Anglia, Bashkimi Sovjetik dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës bënë deklaratë zyrtare me të cilat vlerësohej lufta e popullit shqiptar dhe ripohohej pavarësia e Shqipërisë. Arsyeja kryesore që Lëvizja Nacional-Çlirimtar korri fitore në këtë luftë qëndron tek lufta energjike që zhvilloi Fronti Nacional-Çlirimtar. Pa hyrë në vargun e aksioneve luftarake, mjafton të kujtojmë dy operacionet e mëdha, operacionin e dimrit 1943-1944 dhe atë të qershorit 1944. Pikërisht me luftën heroike që zhvilloi, Fronti Nacional-Çlirimtar e kreu misionin historik dhe i arriti objektivat themelore strategjike: çlirimin e vendit dhe rivendosjen e pavarësisë kombëtare. Lufta Antifashiste Nacional-çlirimtare ishte një provë, që tregoi vlerat morale e politike të çështjes.

Shqipëria në kontekstin urban

Tiparet thelbësore urbanistike, në shtetin Shqiptar, zene fill që në shek XV-XIX, me krijimin e qyteteve mesjetare shqiptare. Gjate kesaj periudhe vihet re një rritje dhe zhvillim i koncepteve urbanistike duke I dhene forme trajtave urbane të qyteteve.

Zhvillimi hapsinor i ketyre qyteteve ndryshonte në varesi të pozites gjeografike, relievit, zhvillimit social dhe atij ekonomik. në kete moment, veme re qytete që dalin pertej mureve të kalave duke shkuar keshtu drejt qyteteve të hapura. Banesat tradicionale dukshem behen ndertimet kryesore të kohes. në afersi të tyre kemi ndertimin e objekteve të kultit dhe në disa raste edhe ndertimeve shoqerore. Me këto ritme, zhvillimi i qyteteve shkon drejt krijimit të lagjeve qendrore dhe atyre periferike.

Shpallja e pamvaresise në vitin 1912, pasohet nga tentativat e ndryshme për të krijuar shtetin dhe politikën e tij. Në këto kuadër, pas viteve 1920, qytetet filluan të kishin plane urbane të zhvillimit, ku u përcaktuan elementet me kryesore:

rruget, ndërtesat kyçe si spitalet, ndermarrjet shtetërore, apo godinat qeveritare.

Ndërsa pas vitit 1944 vihet re lindja e një rryme të re të artit, që kishte lidhje të ngushtë me urbanistikën, në mbështetje të vijës së re ideologjike që pushteti popullor do ndërtonte. Ky lloj artit që zë fill pas çlirimit vendos bazat e një rryme të re në historinë e artit shqiptar dhe njihet ndryshe si “realizmi socialist”

Zhvillimet e reja artistike ishin në kontekst të planeve të përgjithshme urbanistike, të cilat do të luanin një rol kyç në vendosjen e monumenteve, shtatoreve, portreteve, lapidareve, memorialeve dhe mozaikeve, me pak fjale në zhvillimet e veprave publike shqiptare.

Referuar kuadrove të urbanistikës të asaj kohe, në planet e përgjithshme të qyteteve, një vend të rëndësishëm zinte projektimi i parqeve, lulishtave, apo ambjenteve rekreative të perbashketa. Këto të fundit përveç funksionit të tyre primar për të cilin ishin projektuar, shërbenin edhe si “shpëtim” të monumenteve apo veprave të artit.

Këto vepra përdoreshin për të krijuar një karakter apo dizajn të veçantë dhe unik në zonë. Për efekte vizive dhe estetike, objektet dekorative në parqe nuk ngriheshin shumë lart, duke qenë konform urbanistikës dhe vete dimensionit të parkut, në këto mënyra këto vepra ishin dhe me afër shikuesit.

Perzgjedhja për vendosjen e tyre nuk ishte aspak e rastësishme, gjithçka ishte e miremenduar dhe konform legjislacionit në fuqi. Nuk mund të thuhet se ka pasur një ligj apo dekret specifik në lidhje me këtë çështje, por për secilin objekt kishte një vendim të veçantë nga komiteti ekzekutiv i asaj kohe.

Rrugëtimi për vendosjen e një monumenti apo veprë arti, fillonte që nga perzgjedhja që pushteti qendror, i bente figurës ose ngjarjes, në bazë të peshës që kishte pasur gjatë Luftës Nacional-çlirimtare, duke u pasuar nga një konkurs me pjesëmarrjen e një grupi të madh artistesh.

Bocetet e propozuara nga artistet ekspozoheshin, dhe vlerësoheshin nga një juri profesionale, e cila vlerësonte disa faktore, ndër të cilët me të rëndësishmit, ishin:

- Vija ideologjike e interpretuar në art
- Vlerat artistike, që duhet të ishin konform rregullave të realizmit socialist
- Përshkrimi sa më i saktë i ngjarjes, me mjetet shprehëse të artit në të cilin zhvillohej konkursi.
- Perzgjedhësit kishin në qendër të vëmendjes gjithashtu dhe kontekstindhe të veprës si dhe mënyrën e realizimit dhe të trajtimit të veprës.

Në përmbyllje të konkursit, pushteti i delegohej atij lokal, komitetit ekzekutiv, dhe zyres së urbanistikes për të percaktuar vendqendrimin e veprës. Kjo e fundit duke studiuar sheshet, dimensionet e monumentit por edhe konteskti historik ku luftetari, brigada, poeti, apo figura e shquar, percaktonte pozicionimin e kesaj vepre në qytet.

Ajo që vlen të permendet është se si pushteti qendror dhe ai vendor, në perberjen e tij kishte komisione të specializuar ekspertesh të fushave të ndryshme, që nga artistet, arkitektet, urbanistet, historianet, trashëgimia kulturore dhe sportive etj.

Keto vepra arti perpos faktit që vendoseshin në vende ku ishin lehtësisht të dukshme dhe të aksesuehme por gjithashtu sherbenin si pike reference e sheshit ose vendit ku do qendronin. Pozicionimi i tyre në lulishte apo park të qytetet, permiresonte mjedisin publik dhe rriste fluksin e vizitoreve në ate zone.

Kjo ishte situatë urbanistike në qytete dhe në zonat e mëdha urbane, ndërsa për sa I përket fshatrave dhe akseve kombëtare të qarkullimit, çështja ishte pak ndryshe, pasi shpesh herë ngjarja e vendosjes së një monumenti ose lapidary, merrte dimensione edhe më të mëdha se nëpër qytete, për shkak të jetës së limituar kulturoro-artistike në ato zona.

Ndërsa akset kombëtare pas viteve të çlirimit, filluan të projektohet në kontekst të ngjarjes së luftës, dhe shpesh herë këto ngjarje patën kaq shumë rëndësi sa ndikuan në dhënien preçedencë, për ndërtimin e rrugëve dhe urbanizimin parësor, të zonave dhe fshatrave, që kishin një të kaluar të ndritur gjatë luftës antifashiste Nacional-Çlirimtar.

Dhe si rrjedhojë këto akse rrugore, që ndërtoheshin shpesh mbi rrugët e luftës, nuk mund të imagjinoreshin pa lapidarët dhe memorialet përkatëse të luftës.

Ajo që vlen për tu përmendur është se në realizimin e këtyre monumenteve të luftës, ishin të përfshira që nga pushteti qendror, ai lokal, e deri tek entet lokale dhe vullnetarizmi në realizim, ose përpunimin e peisazhit përreth.

Kategorizimi I monumenteve apo veprave të artit

Monumentet publike të pasluftes së dytë botërore, ndahen në dy gjini të mëdha artistike që janë:

1. SKULPTURE

Skulptura si gjuhë bazike shprehjeje ka perparësi në kuadrin urbanistik pasi mund të kundrohët në 360 grade, dhe mund të adoptohët në gjini të ndryshme të saj, gjithashtu në dimensione, që i shkojnë për shtat kontekstit urbanistik. Nga ana funksional ka perparësi pasi mund t'i rezistojë kohës e ndërtuar në materiale solide, dhe agjenteve atmosferik.

Skulptura ka si bazë dy gjini të mëdha plastike që janë skulptura e rrumbullaket, ose siç quhet ndryshe figuracioni 3 dimensional, dhe relievi në dy dimensional (basoreliev dhe altoreliev). Këto dy gjini të mëdha plastike të skulpturës perkthehen në lloje dhe nenlloje shprehjeje, në baze të eksperiencave të ndryshme të Artit Botëror, të adaptuara me sukses nga pionieret e Artit dhe Skulpturës shqiptare, të cilët i perdoren me sukses dhe profesionalisht, për të pasqyruar figurativisht atë çfarë ishte memoria e luftës së dytë botërore dhe me tej.

Llojet dhe nenllojet e Skulpturës, si baze shprehjeje janë:

1.1. Portret (bust)

Portreti është ndër llojet më të përhapura të skulpturës, i përdorur në memorialet e pasluftës së dytë botërore. Ky lloj i skulpturës është i ndërtuar në skulpturë tre dimensionale, dhe me prerje zakonisht deri tek shpatullat. Zakonisht pasqyron figurat e ndryshme të dëshmoreve të rënë gjatë luftës. Si lloj i skulpturës u instalua me tepër nëpër lulishte, në zonat e urbanizuara, duke pasur edhe një rol funksional, si skulpturë parku. Zakonisht janë të vendosura mbi një bazament rreth 2 metra, me forme paralelopipedi ose cilindrike. Gjithashtu kemi raste kur portretet u trajtuan dhe në relief, por shumë më rrallë se trajtimi në tre dimensional.

Portretet zakonisht punoheshin nga emra të njohur të skulpturës së kohës. Portretet në rastet me të shumta janë të realizuara në beton (mendohet me tepër për koston e lirë dhe rezistencën në ambiente të jashtme të këtij materiali), por nuk mungojnë edhe derdhjet në bronz të portreteve.

1.2. Shtatore (figure)

Shtatorja nga vete emri ka si tematike figuren njerëzore, heronjtë e luftës për të cilët folëm dhe më sipër, shpesh herë u trajtuan si figura integrale, në këmbë ose të ulur. Rastet e shtatoreve për heronjtë e luftës së dytë botërore janë shumë të shpeshta, ata dominonin sheshe qendrore në qytete, duke pasur një rol qendror në urbanistikën e qyteteve, ndryshe nga portretet që vendoseshin nëpër lulishte. Gjithashtu i gjejmë gadi të perhershme në varrezat e dëshmorëve në qytete të ndryshme. Ka shumë raste që këto figura përveç armeve (si simbol i luftës) janë të shoqeruara me elemente të tjera simbolike të periudhës së komunizmit, siç janë flamujt me yje, kapelet po me yje, ndonjë herë tjetër me kazëm, lopatë, drapër ose çekan. Në një shumicë rastesh këto figura në sfond të afërt kanë lapidar të kompozuar. Materialet në të cilat u realizuan janë me tepër bronzi dhe betoni.

1.3. Grup skulpturor

Grupi skulpturor, përmban dy ose me shumë figura qofshin ato njerez, ose edhe nga bota shtazore, të ndërtuar në dy gjinitë e skulpturës (skulpturë tre dimensionale dhe relief)

Shpesh herë relievin dhe skulpturën tre dimensionale e gjejmë të perzier tek grupet skulpturore.

Si pjese shumë e rendesishme e grupit skulpturor, është edhe ekuestri (figura mbi kale) jo shumë e përdorur në veprat me tematike nga lufta e dyte botërore. Grupet skulpturore me frekuenca të gjejmë ndër lapidaret e luftës së dyte botërore, dhe ajo që vlen për të përmendur I gjejmë në formën e basorelievit. Si dy gjinitë e lartpërmendura, edhe grupet skulpturore në pjesën më të madhe janë të ndërtuara në beton, shumë prej tyre i gjejmë edhe në Bronx.

Permbledhje

Tri llojet e skulpturës që përmendëm më lart, I gjejmë si pjesë integrale të urbanistikës së qyteteve, ose më shpesh në formën e lapidareve, si komplekse skulpturore brinj rrugëve nacionale.

Shpesh herë janë të trajtuara në gjininë e skulpturës së parkut.

Por ka edhe një rast që lapidaret nuk janë të ndërtuara me gjininë e skulpturës, por rrijnë si elemente më vete, në formën e strukturave vertikale në beton, me disa këmbë shkalle (nga tri e lart) një sheshpushimi përpara.

Zakonisht strukturat janë në forme gjeometrike të thjeshtuara, dhe në pjesën ballore të sipërme dominohen nga ylli me pesë cepa, ose flamuri shqiptar me yll.

Gjithashtu në pjesën qendrore lapidaret kishin të vendosura, pllaka treguese të gdhendura në gur, në të cilat ishte përshkrimi I ngjarjes, dhe emrat e heronjve.

2. PIKTURE

Piktura ishte me frekuenca të ambientet e brendshme, si në ambientet e enteve dhe institucioneve të ndryshme, gjithashtu dhe në Galeritë e Arteve dhe qendrat kulturore të qyteteve dhe fshatrave, por kjo për në nuk përben objekt studimi, pasi nuk janë vepra publike.

2.1. Mozaiku

Nga gjininë e pikturës mozaiku është më I ruajturi, për shkak të rezistencës që ka ndaj demtimeve dhe agjenteve atmosferik, ishte I paket në ambiente të eksterierit, dhe shumë me frekuent në ambientet e brendshme. në ditët e sotme shumë mozaikë janë të mirëruajtur.

2.2. Piktura murale

Edhe piktura murale po ashtu si mozaiku ishte me frekuent në ambientet e brendshme të institucioneve, por më ndryshim nga mozaiku, për arsye fizike, shumë nga objektet e kësaj gjinije janë eliminuar.

2.3. Pllakat

Ne veprat publike pikturore të kohës një vend të veçantë zinte pllakati. Pllakati është me teper në gjininë e dizajnit, dhe nuk përmban nivel artistik, por thjesht artizanal. Ishte i vendosur në udhekryqe dhe në oborret e uzinave dhe fabrikave, ishin të ndertuara në telajo dhe në beze, por në shumë raste dhe në formën e pictures murale. Nga pllakatet kishte mjaft që flisnin për luftën e dytë botërore, dhe simbolikat e saj, ndërsa pjesa më e madhe ishte për arritjet në punë (ndertimin e socializmit) dhe vijën ideologjike të kohës.

Nga pllakati nuk kemi të ruajtur asgjë, pasi për publikun pas viteve 90 ishin të padëshiruara, dhe mund të hiqeshin lehtësisht.

Ka dhe disa objekte që gjë përpara viteve 90 ishin mjaft evidente, pasi ishin të instaluar në faqe malesh, këto ishin shkrimet e dimensioneve shumë të mëdha, si : PARTI ENVER, LAVDI PPSH etj, të cilat ishin të konceptuara, si një ndërthurje e gjinise së "LAND-ART" dhe PLLAKATIT. Këto objekte nuk ekzistojnë më, në raste shumë të rralla janë të tjetërsuara, ose ka ngelur ndonjë detaj.

Nje list e zgjeruar e monumenteve

NR	EMER	AUTORI	VITI I NDERTI MIT	QYTETI / VENDI	EVENTI QE SHENUAR	KOORDINATA T GJEOGRAFIK	PERSHKRIM I SHKURTER	FOTOGRAFI
1	Mother Albania (Tirana)	Kristaq Rama, MumtazDhrami , ShabanHaderi	1971	Tirane	Glorifikon fitoret	41.308655, 19.840061	Veper simbolike kushtuar atdheut dhe deshmoreve ne moment triumfi.	

WWII-MONUMENTS

2	Partizani i panjohur (Tirana)	Andrea Mano	1949	Tirane	Mbarimin e luftes kunderfashizmit	41.328242, 19.821318	Mbarimin e luftes kunderfashizmit	
---	--	-------------	------	--------	---	-------------------------	--------------------------------------	---

WWII-MONUMENTSEE

3	Partizani çlirimtar (Permet)	OdisePaskali	1964	Permet	Ne nderim te Kongresit te Permetit	40.233446, 20.353979	Ne nderim te Kongresit te Permetit	
---	------------------------------------	--------------	------	--------	--	-------------------------	---------------------------------------	---

WWII-MONUMENTS

4	Shtatorja e MujoUlqinakut (Durres)	Kristaq Rama		Durres	Luftetari MujoUlqinakut	41.309795, 19.446710	Ne nderimte figures se MujoUlqinakut. <u>7 prill 1939</u> gjatë <u>pushtimit fashist të Shqipërisë</u> .	
5	Grushti I Mushqetase (Berzhite)	HektorDule	1968	Berzhite	Prite lufte	41.252872, 19.892674	Pritaqe I behet Gjermaneve nga forcat partizane	

WWII-MONUMENTS

6	Kamëz			Kamëz	Lapidar pune	41.361174, 19.771637	Lapidar te punes socialiste	
7	Pezë e Vogël	Mumtaz Dhrami , Kico Krisiko		Peze e vogel	Lufta e Pezes	41.259302, 19.690401	Rezsitencia antifashiste	
8	Elbasan	Sigfrid Mullisi, Kujtim Kprencka Dhimiter Telezi Ark. Ilir Shuteriqi	1982	Elbasan	Brigada e 15 sulmuese	41.112809, 20.073775	Lufta e brigates 15 sulmuese kunderluftes me gjermanine naziste	

WWII-MONUMENTS

9	Lapidari (Shkoder)	HashimKruja	1964	Shkoder	Data e formimitte Brigades 27 sulmuese	42.067957, 19.514253	Formimi I brigata e 27 sulmuese	
10	Pishkash	Perikli Culi		Pishkash	Ne nderim te brigades sulmuese	41.0737532, 20.4997571	Marshimi luftarak Brigadës së Parë Sulmuese në Operacionin Armik të Dimrit 1944	

WWII-MONUMENTS

11	5 Heronjte e Vigut (Shkoder)	ShabanHaderi	1985	Shkoder	Heroizmin e 5 heronjvet e Vigut	42.089269, 19.507358	Monumentii "5 HeronjvetëVigut" në kujtim të heronjve të popullit Ahmet Haxhia, Naim Gjylbegu, Ndoc Mazi, Hydajet Lezha dhe Ndoc Deda	
----	---	--------------	------	---------	---------------------------------------	-------------------------	---	---

WWII-MONUMENTS

12	Nenudhet e luftes (Tirane)	HektorDule	1974	Tirane	Memorie e autorit	41.313715, 19.817975	Memoriengamosha 6 vjecare , per gjatefutjes se brigades 8 sulmuese ne qytet	
13	Monumenti i rezistencës (Durres)	HektorDule FuatDushku	1970 - 1988	Durres	Ne memorie te luftes heroike te partizaneve te luftes	41.309381, 19.444582	Ne memorie te luftes heroike te partizaneve te luftes	

WWII-MONUMENTS

14	Busti i Vasil Lacit (Tirana)	ThomaThomai	1975	Tirane	Ne nderim te kontributit te dhene ne lufte	41.329635, 19.813656	Ne nderim te kontributit te dhene ne lufte	
15	Prita e Barmoses (Barmash)	ThomaThomai	1984	Barmash	Prita e Barmashit	40,273347 20,608123	Aktet heroike te luftetareve partisane ne mbrojtje te atdheut	

WWII-MONUMENTSEE

16	Relievi (Permet)	ThomaThomai	1970	Permet	Partizani I Permetit	40.234824, 20.355360	Lapidar ne nderim te partizaneve te rene ne Permet	
17	Memoria li I Boroves (Borove)	ThomaThomai	1988	Borove	Prita e Boroves	40.310127, 20.652050	Vasja e 109 persona per 2 minuta kur shkonin drejt aeropotit te Janines	
18	Varrezat e deshmor eve (Lezhe)	Pushtetilokal		Lezhe	LuftNacionalCli rimtare	41.777671, 19.652045	Vendikupushojneterenet e luftes ne Lezhe	

WWII-MONUMENTS

19	Lapidari i luftes se Recit (M.Madhe)	Pushtetilokal	1967	Malesi e Madhe	Luften e Recit	42.234033, 19.534547	Pekujton luften e Recit	
20	Mozaiku u Muzeut Historik (Tirane)	Vilson Kilica, Josif Dobroniku, Agim Nebiu, Anastas Kostandini, Aleksandër Filipi	1982	Tirane	Historine e Shqiperise qe nga antikiteti deri ne clirim	41.329338, 19.817456	Historine e Shqiperise qe nga antikiteti deri ne clirim	

Pershkrimi i rrugeve kulturore potenciale te monumenteve te luftes se dyte boterore

Veprat e Thoma Thomai Dhamo

Emri i Thoma Thomai Dhamo, eshte i lidhur ngushte me skulpturen dhe skulptoret e medhenj shqiptar, qe ne rinine e tij te hershme.

Nxenes liceu nen kujdesin e Odise Paskalit, dhe I diplomuar ne Prage te Cekise, ne vitin 1969, themelon atelierin e arteve te aplikuar, prane ish-Institutit te Larte te Arteve Tirane.

Edukimi i disa brezave me rradhe ka qene nje fushe primare per te qe nga viti 1968.

Dekani i pare Fakultetit te Arteve te Bukura, qe nga viti 1995, vit ne te cilin merr dhe titullin profesor. Rektor i Universitetit Polis ne themelimin e tij.

Skulptura e Thomait ka nje pershtatje teme -forme-dinamike-dimension me nje koordinim te admirueshem.

Veprat e tij shquhen per nje ndjeshmeri te larte plastike. Tipar tjetër I skulptorit eshte perzgjedhja me shume kujdes e elementeve te perdorur ne vepren e tij.

Siluetet karakterizohen nga nje studim i thelle gjeometrik, dhe autori ndalon pikerisht ne prerjen me te studiuar kompozicionale .

Veprat e tija njihen gjeresisht edhe jashte kufijve te Shqiperise, me basorelieve, monumente qe nga Tirana e gjer në Shkup, nga Borova e Kolonjës në Zidoll të Krujës, nga figura e Skënderbeut, tek Nënë Tereza . Konkretisht ne propozojme:

I. Prita e Barmoses Barmash , Bashkia Kolonje

Prita e Barmashit, realizuar ne vitin 1984, skulptori perzgjedh pikerisht njeskene luftimesh, dhe e perkthen ne nje dyfiguresh dinamik me nje forme dhe plastike spektakolare, qe pershtatet mrekullisht me temen.

Nderthurja e vepres me relieving eshte mjeshterore, vepra kthehet ne nje pjese integrale te relievit natyror, duke e pasuruar ate ndjeshem.

II. Relievi Permet, Bashkia Permet.

Vepra I kushtohet partizaneve dhe partizaneve te Brigades se VI Sulmuese, per luftimet e kryera gjate vitit 1944.

Lapidari u realizua ne vitin 1970. Lapidari zhvillohet ne dy nivele, I pari ngrihet mbi nje platforme prej shtate kembesh shkalle, qe shoqerohet nga kopshte me lule dhe bime decorative nga anash, ndersa vete lapidary ngrihet mbi nje tjetër sheshpushim, qe mberrihet nga shtate kembe shkalle te tjera.

Lapidari ne vetvete zhvillohet ne dy dimensione, ai horizontal, me nje gjatesi rreth 15 m, dhe nje lartesi mbi 3m, mbi te cilin eshte I vendosur dhe basorelievi I punuar nga skulptori Thoma Thomai.

Dhe dimensionin vertikal, qe ngrihet ne formen e tri kolonave ne forme paralelopipedi, ne nje lartesi rreth 10 m nga bazamenti.

Basorelievi ka nje figure te vetme partizani ne ecje me pushke ne dore, dhe eshte I punuar ne bronx. Figura eshte e punuar me nje gjuhe te thjeshtuar plastike, dhe qe nga larg dallohet qe eshte veper e autorit te lartpermendur, per nga karakteristikat plastike dhe kompozicionale.

III. Memoriali i Boroves (Borove), Bashkia Kolonje.

Vepra I kushtohet masakres se Boroves me 6 korrik 1943, ku u masakruan dhe u dogjen 107 femije, te rinj, pleq e plaka.

Vepra u konceptua nga arkitekti Vladimir Bregu, ne formen e nje memoriali me dimensione mjaft te konsiderueshme, ne nje koder, ku pjese e rendesishme e kompleksit, pervec varreve te te reneve , jane dhe tre Basorelievet, dhe nje dyfiguresh I autorit tone Thoma Thomai Dharmo.

Basorelievi me i rendesishem dhe me virtuoz i kompleksit eshte ai I skenes se djegjes, dhe I pushkatimit te 8 prej figurave te perzgjedhura me kujdes nga autori, nje nga te cilat eshte foshnje. Plastika eshte dritheruese po aq sa prerja kompozicionale. Ka nje zhvillim horizontal, qe shoqerohet nga plastika e flakeve te zjarrit, dhe shquhet per shume dinamizem, gje qe I jep vepres mjaft dramaticitet.

Basorelievi I dytë paraqet aktin e pushkatimit dhe te zjarrhedhjes nga trupat naziste, ne drejtim te popullates se pafajshme. Kjo scene eshte me statike se e para, ritmi I helmetave te kujton paksa basorelievin e Vasil Laçit, por plastika eshte me e thelle dhe me aggressive, si vete akti qe shoqerohet. Pjesa e plastikes se flaskeve duket sikur ben lidhjen kronologjiko-plastike me basorelievin tjetër, dhe I shton dramaticitetin aktit. Pamvaresisht se dy basorelievet ndodhen ne distance nga njeri-tjetri, ato duket se jane pjese integrale e nje vepre te tere.

Basorelievi I trete ka forme me tradicionale, pasi brendashkruhet ne nje drejtkendesh te rregullt, permбан gjashte figura , dhe pershkruan skenen enjerezve para aktit te egzekutimit barbar. Figurat jane ne kembe dhe perçojne pritjen plot ankth, qe do shoqerohet me vone ne veperat, e lartpershkruara. Qe te tri veprat jane te integruara mjaft mire ne sipërfaqen e

ndertuar me gur te latuar te mureve perimetral, dy te parat jane ne brendesi te varrezes, ndersa relieve I trete ne hyrje te saj.

Nqs tre basorelievet e siperpermendura, mbartin nje trishtim te madh per vete natyren e ngjarjes, dyfigureshi ka si permbytje nje skene triumfi static, dhe paraqet nje partisan me nje vajze te vogel. Q e te dy figurat jane ne kembe me nje shikim te hedhur diku tej.

Partizani ka mbeshtetur doren e tij te majte mbi supin e vajzes, me nje gjest perkedhelije dhe mbrojtjeje. Ndersa nen kemben e tij te djathte ka nje helmete gjermane.

Format jane mjaft te thjeshtuara, dhe plastika eshte e plote dhe e sakte.

Dyfigureshi mbyll kompleksin e skulpturave te Memorialit te Boroves.

IV. Basoreliev i Vasil Laçit Tirane, Bashkia Tirana

Basorelievi I kushtohet atentatit te te riut Vasil Laçi me 17 maj 1941 ne Tirane, kunder perandorit te Italisë fashiste Viktor Emanueli III .

Vepra u realizua ne vitin 1975.

Zgjedhja kompozicionale qe autori i ben vepres eshte njeheresh e thjeshte dhe e zgjuar, pasi figuren e heroit e vendos ne qender, me nje levizje impulsive plastike. Ndersa sfondin e mbulon me ritmin e helmetave dhe bajonetave, qe pamvaresisht se rrine qete dhe perseritet si plastike, mbart njelloj agresiviteti ne impresion. Edhe shkrimet qe ndodhen ne pjesen e poshtme te reliefit, jane te integruara mjaft mire me pjesen tjeter te tij, si nga ana e ritmit, hapsires, dhe e plastikes.

Veprat e Hektor Dule.

Nje nder skulptoret me me emer ne Shqiperi, u lind ne Permet me 3 janar te vitit 1939.

I njohur per nje sere veprash te rendesishme, duke perfshire gjinite e larmishme nga nudo deri tek bustet, shtatoret e monumentet historike.

Punimet e tija njihet ne te gjitha trojet shqipfolese.

Ne propozojme qe te kemi nje rrugetim kulturor te veprave te tija, pasi eshte nje nder iniciatoret e zhvillimit te disiplines se reliefit si nje nder lendet profesionale baze ne ish-Institutin e Larte te Arteve , dega Skulpture.

Njohes mjaft I mire I marrdhenies se Skulptures Monumentale me kontekstin Urbanistiko-Arkitekturor, dhe kjo fale studimeve te tij ne Prage te Cekise, dhe eksperiences se tij ne pune prane ish-Komitetit Egzekutiv te Tiranes (Bashia e sotme) ne sektorin e Urbanistikes, si ndertues maketesh ne bashkpunim me arkitektet dhe urbanistet me emer te asaj kohe.

Skulpturat e tij dallohen per dinamizmin e levizjes dhe plastikes.

Energjia qe ato mbartin eshte mjaft e veçante, dhe ne te shumten e rasteve transformohet ne nje ekspresionizem vibrues.

Siluetet e figurave te tij levizin zhdervjellet, dhe skulptura ka interes ne te gjitha pikat e pamjes. Objektet qe ne propozojme jane:

I. Ne udhet e luftes, Tirane.

Bashkia Tirane, vepra ndodhet tek kodrat e liqenit artificial Tirane, dhe u realizua ne vitin 1974.

Kjo skulpture ne dyfiguresh, pervec vlerave te veçanta estetiko-plastike, veçohet dhe per historine e saj te veçante, e cila na u rrefye nga vete autori, pasi e merr shtysen nga nje ngjarje e femijrise se hershme te autorit(qe ne moshen 6 vjeçare) kohe ne te cilen nje nga brigadat sulmuese, hyn triumfuese ne qytetin e Permetit.

Skena e dhenies uje eshte kaq reale, dhe eshte kaq e perjetuar saqe ka te perzier fundin e vuajtjes se luftes, me nje idil dashurie dhe triumfi .

Idili I dashurise lexohet ne nderthurjen e figurave, dhe gjestikulacionin e tyre, siluetet e tyre rrijne kaq embel e natyrshem me njeri –tjetrin, saqe skulptura dyfigureshe rri qete tashme ne nje kufi conceptual, si ai I fundit te luftes (qe mbjell vdekjen) per tek triumfi I jetes, dhe I dashurise. Dyfigureshi rri natyrshem me peisazhin tashme, jo aq si memorial lufte, por si sculpture e mirfillte parku.

II. Monumenti i rezistences Durres. Bashkia Durres.

Shtatorja u realizua ne vitin 1988, dhe eshte nje bashkpunim I frytshem I autorit me skulptorin tjetër Fuat Dushku.

Dimensionet ne total me gjithë bazamentin i kalojne 11 m. Bazamenti eshte mjaft imponent dhe ngrihet ne 10 nivele te shkallezuar progressive betoni.

Shquhet jo vetem per siluetin e tij dinamik, dhe per vendosjen mjeshterore ne shesh, por edhe plotesine e formave deri ne detaje.

Figura ne total eshte shume mire e ndertuar, dhe raportet anatomike, lexohen mjaft mire, dhe jane te koordinuar bukur me gjuhen skulpturore. Per ata qe e njohin skulpturen , kjo veper pavarisist se ka si tematike luften, ka nota te thella te skulptures lirike.

III. Grushti i Mushqetase(Berzhite) Bashkia Tirane.

Kjo veper monumentale u realizua nga Hektor Dule ne vitin 1968, I kushtohet betejes se Mushqetase, me 14 nentor 1944.

Kjo betetje njihet si nje nder humbjet me te medha te nazistëve gjerman ne Shqiperi.

Vepra eshte e realizuar ne beton dhe karakterizohet nga nderthurja e dy gjinive te sculptures ,ajo e basorelievit dhe e skulptures se rrumbullaket, te nderthurura qe te dyja me mjaft mjeshtri nga autori.

-Skulptura tre dimensionale e grushtit gjigand qe mban pushken dhe flamurin, eshte mjaft statike dhe e ndertuar fuqishem me nje plastike te ngjeshur. Detajet jane te punuara me kujdes, dhe segmentuara nga njeri tjetri.

-Ndersa plotesohet nga siperfaqja e qete e basorelievit e punuar me mjaft elegance, dhe mjeshtri nga autori.

Ndersa po te shohim me tej skenat e luftes ne basoreliev, karakterizohen nga nje dinamizem siluetash dhe nje vibracion formash ,qe kontrastojne statizmin e grushtit. Figurat gjithashtu ne relief te habisin me ritmin e tyre te vendosjes, duke na kujtuar deri diku artin e lashte Egjiptian.

IV. Relievi tek Kryeministria ne Tirane, Monument Kulture.

Vepra eshte bashkautoresi e Hektor Dule me skulptoret : Shaban Haderi, Kristaq Rama, Muntaz Dhrami, dhe i perket nengjinise se altorelievit, dmth relievit te larte.

Vepra ndahet ne tre nivele, ai lart i kushtohet LANC, ndersa dy te tjerat me poshte kane si tematike punen dhe ndertimin e socializmit.

Vepra zhvillohet ne simetri vertikale me aks qendror, dhe ajo qe bie ne sy eshte se figurat e segmentit qendror, zhvillohen ne nje dimension me te madh se dysegmentet e tjera.

Vepra dallohet qe eshte ne bashkautoresi pasi pasurohet me gjuhe te tjera plastike, dhe permban elemente artistike te cilat nuk I gjejme ne veprat e tjera te skulptorit.

Shembujt e analizës së detajuar të monumenteve të përzgjedhura

Nga lista e zgjeruar e monumenteve në Shqipëri që ka përfshirë **20 monumente**, janë përzgjedhur **10** për të cilët është bërë analiza e detajuar në bazë të formularit të përcaktuar. Analiza e detajuar është bërë për këto monumente:

1. **Nene Shqiperia**, Tirane; Kristaq Rama, Mumtaz Dhrami, Shaban Haderi
2. **Partizani I panjohur**, Tirane; Andrea Mano
3. **Grushti I Mushqetase**, Berzhite; Hektor Dule
4. **Kamëz**, Kamez
5. **Pezë e Vogël**; Mumtaz Dhrami, KicoKrisiko
6. **Elbasan**; Sigfrid Mullisi, Kujtim Kprencka, Dhimiter Telezi, Ilir Shuteriqi
7. **Lapidari**, Shkoder; HashimKruja
8. **Pishkash**; Perikli Culi
9. **5 Heronjte e Vigut**, Shkoder; Shaban Haderi
10. **Memoriali I Boroves**, Borove; ThomaThomai

Në këtë dokument janë prezantuar dy prej 10 monumenteve të trajtuar në detaje:

- **Nene Shqiperia**, Tirane; Kristaq Rama, Mumtaz Dhrami, Shaban Haderi
- **5 Heronjte e Vigut**, Shkoder; Shaban Haderi

Analizat e detajuara të monumenteve të tjerë të përzgjedhura janë dorëzuar RCC-së.

Nene Shqiperia



BASIC DATA ABOUT THE MONUMENT

Emri zyrtar dhe / apo i zakonshëm i monumentit

Nene Shqiperia

Emri dhe mbiemri i projektuesit / dizajnerit

Kristaq Rama, Mumtaz Dhrami, Shaban Haderi

Dimensionet themelore të monumentit (gjërësia, gjatësia, lartësia)

12 m i larte, i mbështetur ne nje pedestal 8 m

Përshkrimi i karakteristikave vizuale të monumentit / kompleksit memorial

Shtatorja eshte nje figure femerore ne pozicion triumfi e vendosur ne kembe, dhe me nje levizje te lehte te kembeve(gjysem hapi me kemben e djathte perpara). Dora e saj e djathte ngrihet vertikalisht lart, dhe mban nje gjethe dafine, e njohur si simbol i paqes, dhe nje yll me pese cepa, i njohur si simbol i internacionales komuniste. Eshte shume interesante nderthurja e ketyre dy elementeve, pasi yllin ne simboliken komuniste e gjejme kryesisht te nderthurur me draper

çekan, me kazem e pushke, ose mbi shqiponjen dykrenare ne flamur. Keshtu qe nderthurja e ketyre dy elementeve nga autoret ka qene mjaft e guximshme, duke dashur t'i japin me shume hapsire kohore vepres se tyre, aq me teper kur mendohet, qe nje simbol pageje si dafina eshte pika me e larte e varrezave te deshmoreve. Dora e majte e shtatores ngrihet horizontal me supin, dhe vazhdon si pjese integrale e draperise qe shoqeron gjithe shtatoren.

VENDNDODHJA E MONUMENTIT

Shteti

Tirana

Komuna

Tirana

Qyteti

Tirana

Informata gjeografike (gjerësia dhe gjatësia)

41.308655, 19.840061

NDËRTIMI I MONUMENTIT

Data kur filloi ndërtimi i monumentit

1971

Data kur përfundoi ndërtimi i monumentit

1972

Cilës ngjarje historike /person(ave) i dedikohet ky monument? Ju lutemi jepni informata bazë për ngjarjen / person (at).

Veper simbolike kushtuar atdheut dhe deshmoreve ne moment triumfi.

A ka informacion pse monumenti u ndërtua në kohën e caktuar (për shembull, për të shënuar një përvjetor apo ndonjë rast tjetër)?

Nuk kemi arritur te gjejme nje informacion te tille

GJENDJA AKTUALE, MËNYRAT E PËRDORIMIT DHE INTERPRETIMI I MONUMENTIT

GJENDJA AKTUALE

Si është gjendja fizike aktuale e monumentit

Monumenti mabhet ne gjendje te mire

A i është nënshtruar monumenti ndonjë ndërhyrjeje, ndryshimi, shtese, etj? Nëse po, ju lutemi përshkruani ato dhe tregoni nëse ato, sipas mendimit tuaj, kanë kontribuar ose kanë degraduar vlerën e tij.

Nje nderhyrje, e cila eshte evidentuar, eshte rehabilitimi i ketij monumenti ne vitin 2017 nga Bashkia e Tiranës dhe Agjensia e Parqeve dhe Rekreacionit. Ky rehabilitim ka konsistuar ne pastrimin nga bimesia, larjen dhe pastrimin e elementeve te mermerit si dhe restaurime te vogla ne pjesen e bazamentit. Permes kesaj nderhyrje perisazhi urban perreth monumentit eshte sistemuar duke e kthyer keshtu monumentin ne nje atraksion turistik.

PËRDORIMI

Në çfarë mënyra është përdorur monumenti që kur është ndërtuar? Çfarë lloj aktiviteteesh u zhvilluan brenda kompleksit të monumentit dhe cilat palë të interesuara i organizuan ato?

Jane organizuar homazhe ne nderim te heronjve qe kane sakrifikuar per te miren e vendin. Raste konkrete jane aktivitete e pervitshme ku ne daten 5 maj, e cila perkon me ditën e deshmoreve, organizohen perkujtime dhe homazhe nga politikan te ndryshem si Enver Hoxha, Sali Berisha, Edi Rama etj.

Cilat janë aktivitetet dominuese të ditëve të sotme të ndërlidhura me monumentin? (Ju lutemi specifikoni llojet e aktiviteteve dhe palët e interesuara që i kryejnë ato - ekskursione, vizita turistike, përkujtime të përvjetorit të tij ose disa tubime / ngjarje të tjera etj.).

Aktivitetet qe vazhdojne te organizohen jane po ne nderim te deshmoreve te kombit ne daten 5 maj dhe organizohen si nga perfaqesues te pushtetit qendror edhe atij lokal.

INTERPRETIMI DHE PRESENTIMI I MONUMENTIT

A ka ndonjë material edukativ dhe promovues për monumentin (të shtypura dhe digjitale) - broshura, suvenire, filma, video spote, reklama etj? A është përdorur monumenti si skenografi për ndonjë ngjarje? Ju lutemi specifikoni çfarë materiale, kush i krijon ato dhe në çfarë mënyre e përfaqësojnë ato monumentin.

Monumenteve me vlera historike i behet nje promovim permes faqeve te internetit, qe jane lehtesisht te aksesueshme. Konkretisht per monumetin gjejme te dhena rreth tij tek faqja e Agjensise se Parqeve dhe Rekreacionit, ku na jepet nje informacion i plote rreth monumentit ne teresi.

Si e paraqesin monumentin tabelat e informacionit, hartat zyrtare dhe infografikat që ndodhen aty? Cilat janë të dhënat dhe tregimet kyçe që ato paraqesin?

Ka te dhena te ndryshme, si harta, koordinata gjeografike , imazhe fotografike etj, te cilat jane nje pasqyre e plote mbi informacionin e nevojshem per turistat si per historikun e monumentit ashtu edhe per aksesimin e tij.

Komente shtesë

<http://www.arkivalajmeve.com/5-maji-Rama-zhvillon-homazhe-tek-monumenti-Nene-Shqiperi.1047031167/#>

<https://www.voal.ch/tag/nene-shqiperi/>

<https://www.youtube.com/watch?v=fjV11qk8ZPs>

<https://www.gazetaexpress.com/lajme-nga-shqiperia-festat-e-nentorit-bashkia-e-tiranes-rehabiliton-memorialin-nene-shqiperi-457432/>

<https://aprtirana.al/parqe-dhe-objekte-memoriale/parku-i-varrezave-te-deshmoreve-tirane/>

NATURAL SURROUNDINGS

Is the monument situated in or near a protected natural area (a national park, etc.). If yes, please specify which one.

Monumenti pozicionohet ne koder ne afersi te Tiranes, tek varrezat e deshmoreve. Ne afersi te ketyre varrezave ndodhet Parku Kombetar i Tiranes.

What are the specific features and values of the monument's natural surroundings/landscape?

Monumenti pozicionet ne nje koder, e cila eshte edhe "shtepiza" e heronjve tone. Varrezat e deshmoreve jane pjese integrale e kodres.

MJEDISI NATYROR

A ndodhet monumenti në ose afër ndonjë zone natyrore të mbrojtur (park kombëtar etj.). Nëse po, ju lutem specifikoni se në cilën.

Po monumenti ndodhet ne afersi te Parkut te Kodrave te Liqenit si dhe pozicionohet edhe ne afersi te Parkut te Liqenit Artificial te Farkes.

Cilat janë tiparet dhe vlerat specifike të mjedisit natyror / peizazhit përreth monumentit?

te dy parqet jane zone rekreative per baniret, qe kane parqe per pushim, ambjente rekreative per femije dhe te rinj, bar-kafene per te gjitha moshat.

DOKUMENTET STRATEGJIKE DHE TË PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

A është i njohur kompleksi në dokumentet strategjike kombëtare ose lokale (ato që lidhen me zhvillimin, turizmin, planet e biznesit, etj.)? Nëse po, ju lutemi specifikoni se në cilën mënyrë.

Siti eshte i vizitueshem dhe lehtesishit i aksesueshem, kjo per faktin te reklamimit permes aktiviteteteve qe jane organizuar pergjate viteve. Gjithashtu varrezat e deshmoreve jane nje atraksion turistik , qe njihet dhe vleresohet nga turistet.

KORNIZA INSTITUCIONALE: STATUSI I MBROJTJES, MENAXHIMI DHE FINANCIMI

STATUSI I MBROJTJES

A ka monumenti ndonjë status mbrojtjeje? Nëse po, ju lutem specifikoni atë.

Te gjithë monumentet janë pjesë në mirembajtje të bashkive perkatese, por nuk ka një urdher specifik në lidhje urdherin e mbrojtjes.

Nëse monumenti është i mbrojtur, ju lutem tregoni nga cili vit është mbrojtur.

Nisur nga fakti që nuk ka një urdher specifik mbrojtjeje, nuk ka një vit të cilit t'i referohemi

Cili institucion është përgjegjës për mbrojtjen e tij?

Si për mbrojtjen ashtu edhe për mirembajtjen, përgjegjës është bashkia dhe njësia administrative perkatese.

MENAXHIMI DHE FINANCIMI

Cili institucion është përgjegjës për menaxhimin e monumentit apo të kompleksit?

Te gjithë lapidaret janë nën përgjegjësinë e bashkiave dhe njësive administrative perkatese

A ekziston një plan menaxhimi për monumentin? Nëse po, ju lutemi jepni informacionin bazë (periudhën e vlefshmërisë etj.).

Nuk ka asnjë plan menaxhimi në lidhje me mbrojtjen apo mirembajtjen.

A ka raporte monitorimi lidhur me mbrojtjen apo menaxhimin e monumentit? Nëse po, ju lutemi tregoni se kush i përgatit ato, kujt i dorëzohen dhe për çfarë periudhe kohore përgatiten ato?

Nderhyrjet restauruese në monument janë të nivelin pastrim nga bimesia, ose bojatisje, dhe në të tilla kushte nuk ka raporte lidhur me këto mirembajtje.

A ka institucioni përgjegjës për menaxhimin ose kujdesin e monumentit buxhet të caktuar për mbrojtjen apo menaxhimin e tij? Nëse po, cila është shuma e buxhetit?

Nëse dijeni tone, nga interesimi në institucionet perkatese, nuk ka fonde apo buxhet specifik për mbrojtjen e monumentit

A ka ndonjë informatë rreth shpenzimeve aktuale për mirëmbajtje, mbrojtje apo restaurim të monumentit?

Nderhyrjet e vogla restauruese behen nga punonjes te institucionit te cilin e ka nen mbikqyrje dhe si e tille nuk ja nje preventim ne lidhje me keto punime.

A ka ndonjë informatë rreth shumës së të ardhurave totale që rrjedhin nga përdorimi i monumentit (përfshirë donacionet etj.)?

Nuk kemi arritur te gjejme nje informacion ne lidhje me kete informacion.

VIZITAT, OFERTAT DHE PERCEPTIMET TURISTIKE

A ka informacion rreth numrit vjetor të vizitorëve në kompleks? Nëse po, ju lutemi jepni informacionin dhe burimet e informacionit.

Duke mos pasur nje biletari nuk eshte e mundur percaktimi i sakte i numrit te turisteve.

A ka informacion rreth strukturës së vizitorëve? Nëse po, ju lutemi jepni informacionin dhe burimet e informacionit.

Duke njohur historikun e monumentit , mund te themi se vetem nje pjese e turisteve te cilet i interesojne monumentet ne vacanti ose historia e Shqiperise (Tiranes) ne pergjithsi jane te interesuar.

A është hyrja në kompleks me pagesë? Nëse po, ju lutemi tregoni se sa?

Nuk ka asnje pagese per te vizituar monumentin.

A ka sezoni turistik aktual ndonjë karakter të veçantë sezonal? Nëse po, ju lutem specifikoni se cilat periudha i mbulon.

Monumenti vizitohet nga turistet gjate gjithë vitit, me specifikisht ai vizitohet gjate dites se deshmoreve. Gjate kesaj date jane qeveritaret , banda e qytetit dhe ato qeveritare apo organizatorete e ndryshem te aktiviteteteve dhe homazheve qe organizohen ne kuader nderimit te deshmoreve te kombit.

A ekziston aktualisht ndonjë ofertë turistike e përcaktuar për monumentin e përmendur? Nëse po, ju lutemi përshkruani atë duke specifikuar se çfarë përfshin, kush e siguron atë, për cilat grupe të synuara dedikohet dhe jepni një vegëz me informacionet shtesë.

Monumenti është pjesë e disa tureve kulturor. Target grupi është kryesisht mosha e trete, të cilët janë të apasionuar pas veprave të Realizmin Socialist. Një ndër agjensite private të cilat e përfshijnë monumentin si pjesë e guides së saj turistike është Albanian Trip. Gjithashtu është edhe Turisti Shqiptar, një guide private turistike e cila e ofron shërbimin e informimit të turistëve në lidhje me historinë dhe kulturën tone.

<https://www.facebook.com/albaniantriptravel/>

https://www.facebook.com/turistishqiptar/?ref=search&_tn_=%2Cd%2CP-R&eid=ARChiAUMjyns61S0z9F2sm7Q3gusYxnCwyFyhkBlpIAWHU8Wf4rJrOwkSXquiPjENz9EQmlPzXoFPxEs

Bazuar në analizën e kryer të platformave online dhe rrjeteve sociale (Foursquare, TripAdvisor, Airbnb, Facebook, Instagram, etj.), cila është përshtypja e vizitorëve ndaj monumentit? (Ju lutemi shënoni fjalët kyçe që i kanë përmendur, komentet kryesore pozitive dhe negative, se si i përdorin hashtag-et etj.).

Jane disa turistë të cilët e kanë përmendur në platforma online monumentin, por duke qenë se fjalët kyçe janë të ndryshme është e pamundur identifikimi i shumicës së postimeve. Kryesisht janë përdorur #NeneShqiper #Varrezat EDeshmoreve #MotherAlbania #NationalMartyr'sCemetery etj

Sipas mendimit tuaj, cili lloj i turizmit do të ishte optimal për këtë monument? Ju lutemi përshkruani shkurtimisht.


Përgjithësisht janë të interesuar ato grupe turistesh të cilët janë më të tërhequr nga kultura. Kryesisht janë mosha e mesme, të cilët kanë dëshirë të njohin më specifikisht historinë dhe kulturën e popullit tonë

INFRASTRUKTURA E TURIZMIT

A ka vend-parking afër monumentit për vetura private, biçikleta dhe autobusë? Ju lutemi përshkruani atë. Ju lutemi tregoni distancën e tij nga kompleksi.

Ka disa vende parkimi, të cilët janë kryesisht për delegacionet që vijnë në rastet kur organizohet homazhet në nderim të dëshmoreve të kombit.

<https://www.google.com/maps/place/41%C2%B018'31.2%22N+19%C2%B050'23.1%22E/@41.3086722,19.8390852,256m/data=!3m2!1e3!4b1!4m14!1m7!3m6!1s0x1350310470fac5db:0x40092af10653720!2sTirana,+Albania!3b1!8m2!3d41.3275459!4d19.8186982!3m5!1s0x0:0x0!7e2!8m2!3d41.308671!4d19.8397529>



A është qasja në monument e projektuar mirë dhe e sigurt? Ju lutemi përshkruani.

Aksesi për në monument realizohet nga dy hyrje. Njera është nga rruga kryesore, lehtësisht e gjendshme dhe shumë lehtë e aksesueshme për të gjithë kategoritë e turistëve. Ndërsa hyrja sekondare është në krahun tjetër, dhe ngjitja bëhet përmes shkallëve, duke bërë kështu jo të aksesueshme nga çdo turist.

A ka qasje për vizitorët me aftësi të kufizuara në monument, p.sh. në të gjitha zonat e qasshme për turistët e tjerë? Ju lutemi përshkruani.


Aksesi për persona me aftësi të kufizuara mund të bëhet nga hyrja kryesore e cila është e shtruar me asfalt dhe në kushte të mira.

A ka tualete në kompleks? Ju lutemi tregoni distancën e tyre nga monumenti dhe nëse gjendja e tyre është e kënaqshme ose e pakënaqshme (gjendja fizike, mirëmbajtja...).

- Po, ka një njëje higjienosanitare brenda rrethimit të monumentit. Tualet nuk ishin në gjendje shumë të mira, dhe nuk ishin restauruar në ditët e sotme.

<https://www.google.com/maps/place/41%C2%B018'29.6%22N+19%C2%B050'26.1%22E/@41.3082275,19.8397897,305m/data=!3m2!1e3!4b1!4m14!1m7!3m6!1s0x1350310470fac5db:0x40092af10653720!2sTirana,+Albania!3b1!8m2!3d41.3275459!4d19.8186982!3m5!1s0x0:0x0!7e2!8m2!3d41.308671!4d19.8397529>

[92af10653720!2sTirana,+Albania!3b1!8m2!3d41.3275459!4d19.8186982!3m5!1s0x0:0x0!7e2!8m2!3d41.3082265!4d19.8405859](https://www.google.com/maps/place/41°18'29.6\)



A është kompleksi i pajisur me mobilar urbane, stola/ulëse, kosha për mbeturina etj. Ju lutemi përshkruani.

Po, ne zone ku eshte pozicionuar mobimenti kemi nje sistemim urban te pajisur me elementet e arredimit urban si stola, kosha, ndricues.

A është kompleksi i pajisur me infografikë, shenja, mbishkrime etj. në gjuhë të ndryshme? Ju lutemi përshkruani.

Jo, nuk kemi vene re asnje tabele informuese

A ka ndonjë burim të ujit të pijshëm në kompleks ose në afërsi të tij (ju lutemi shënoni se ku)? Ju lutemi përshkruani nëse ai është burim i natyrshëm i ujit, nëse ndodhet brenda një ndërtese etj.

E vetmja mundesi tek e cila mund te perdoret uji per nevoja te ndryshme eshte te nyjet higjonesanitare..

A ka ndriçim në kompleks? Ju lutemi përshkruani.

Po, ka ndricim edhe pergjate nates

A ka kompleksi mbulueshmëri nga ndonjë rrjet celular, WI-FI etj.?

Po, ka mbulim nga rrjetet telefonike qe operojne ne Shqiperi

Në çfarë distance nga kompleksi mund të gjendet ndonjë kafene, restorant dhe vend për akomodim?

GRUPET E INTERESIT

- Bashkia Tirane
- Presidenca
- Kryeministria

5 Heronjte e Vigut



TË DHËNAT THEMELORE PËR MONUMENTIN

Emri zyrtar dhe / apo i zakonshëm i monumentit

5 Heronjte e Vigut

Emri dhe mbiemri i projektuesit / dizajnerit

Shaban Haderi

Dimensionet themelore të monumentit (gjerësia, gjatësia, lartësia)

monumenti i derdhur ne bronx eshte 6 m i larte.

VENDNDODHJA E MONUMENTIT

Shteti

Shkoder

Komuna

Shkoder

Qyteti

Shkoder

Informata gjeografike (gjerësia dhe gjatësia)

42.089269, 19.507358

NDËRTIMI I MONUMENTIT

Data kur filloi ndërtimi i monumentit

1985

Data kur përfundoi ndërtimi i monumentit

1985

Cilës ngjarje historike /person(ave) i dedikohet ky monument? Ju lutemi jepni informata bazë për ngjarjen / person (at).

Monumenti i "5 Heronjve të Vigut" në kujtim të heronjve të popullit Ahmet Haxhia, Naim Gjylbegu, Ndoc Mazi, Hydajet Lezha dhe Ndoc Deda

GJENDJA AKTUALE, MËNYRAT E PËRDORIMIT DHE INTERPRETIMI I MONUMENTIT

GJENDJA AKTUALE

Si është gjendja fizike aktuale e monumentit

Monumenti është pjesërisht i demtuar si shkak i zhvendosjeve të here pas hershme dhe mos restaurimit.

A i është nënshtruar monumenti ndonjë ndërhyrjeje, ndryshimi, shtese, etj? Nëse po, ju lutemi përshkruani ato dhe tregoni nëse ato, sipas mendimit tuaj, kanë kontribuar ose kanë degraduar vlerën e tij.

Po monumenti i është nënshtruar ndërhyrjeve dhe ndryshime. Bazamenti i monumentit ka ndryshuar pasi i është pershtatur hapësira në të cilën është vendosur.

PËRDORIMI

Në çfarë mënyra është përdorur monumenti që kur është ndërtuar? Çfarë lloj aktiviteteve u zhvilluan brenda kompleksit të monumentit dhe cilat palë të interesuara i organizuan ato?

Në fillim ishte i pozicionuar në një rreth rrotullim në qendër të qytetit dhe si i tillë ka luajtur një rol dekorativ për qytetin përveç vlerave historike në kumtimin e një ngjarjeje domethënëse për vendin. Gjatë levizjes së parë u spostuar në varrezat e deshmorëve dhe në këtë kuadër u kthye në një monument që reflekton vecse një moment historik siç ishte historia e 5 heronjve të Vigut. Zhvendosja e dytë ju bëri të pozicionuar në një periferi të qytetit.

Cilat janë aktivitetet dominuese të ditëve të sotme të ndërlidhura me monumentin? (Ju lutemi specifikoni llojet e aktiviteteve dhe palët e interesuara që i kryejnë ato - ekskursione, vizita turistike, përkujtime të përvjetorit të tij ose disa tubime / ngjarje të tjera etj.).

Aktivitetet që vazhdojnë të organizohen janë po në nderim të deshmorëve të kombit në datën 5 maj dhe në periudhën e clirimit 29 Nëntor. Personat që shkojnë janë veteranët e luftës dhe anëtarët e shoqatës LANÇ, të cilët çojnë lule ose kurora në nderim të tyre.

INTERPRETIMI DHE PRESENTIMI I MONUMENTIT

A ka ndonjë material edukativ dhe promovues për monumentin (të shtypura dhe digjitale) - broshura, suvenire, filma, video spote, reklama etj? A është përdorur monumenti si skenografi për ndonjë ngjarje? Ju lutemi specifikoni çfarë materiale, kush i krijon ato dhe në çfarë mënyre e përfaqësojnë ato monumentin.

Ne nderim te tyre si dhe ne kujtim te historise se 5 Heronjve te Vigut , kinostudioja Shqiperia e Re, ka bere filmin me titull "Besa e kuqe" ne vitin 1982 me skenarist Dhimiter Anagnosti dhe regjisor Pirro Milkani. Ne vitin 1977 eshte bere nje dokumentare me titullin "heronjte e Vigut" Gjithashtu ka edhe poezi kushtuar ketyre 5 heronjve, shkruar nga autori Kole Jakova ne vitin 1953.

Si e paraqesin monumentin tabelat e informacionit, hartat zyrtare dhe infografikat që ndodhen aty? Cilat janë të dhënat dhe tregimet kyçe që ato paraqesin?

Monumenti i 5 heronjve eshte lehtesisht i evidentueshme ne website pasi mjafton faja kyce "heronjt e vigut" dhe shpalosen nje sere informacionesh ne lidhje me imazhet e tyre ne nder vite, vendodhja ne harta, histori dhe vepra kushtuar ketij monumenti

Komente shtesë

<https://www.forumishqiptar.com/threads/7316-Kol%C3%AB-Jakova>

<http://evasotiri-poezi.blogspot.com/2011/08/heronjte-e-vigut.html>

<https://www.imdb.com/title/tt0351050/>

https://aktoretshqiptare.info/2018/03/14/filmi-besa-e-kuqe/?fbclid=IwAR1AXE0tK-xPelgyx16E-s_fUlKnhvZsy3CkBUMVBq21471HhY4T6U2cCYk

MJEDISI NATYROR

A ndodhet monumenti në ose afër ndonjë zone natyrore të mbrojtur (park kombëtar etj.). Nëse po, ju lutem specifikoni se në cilën.

Ne asnjërin nga pozicionet monumenti nuk ka qene i pozicionuar ne afersi te ndonje parku kombetar.

Cilat janë tiparet dhe vlerat specifike të mjedisit natyror / peizazhit përreth monumentit?

Ne pozicionin e sotem , ai ndodhet ne rrethrotullim, ne kryqezim rruges. Pozioni i tij aty eshte i favorshem pasi sherben edhe si landmark per zonen.

DOKUMENTET STRATEGJIKE DHE TË PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

A është i njohur kompleksi në dokumentet strategjike kombëtare ose lokale (ato që lidhen me zhvillimin, turizmin, planet e biznesit, etj.)? Nëse po, ju lutemi specifikoni se në cilën mënyrë.

Siti eshte i vizitueshem dhe lehtesishit i aksesueshem, kjo per faktin se pozicionohet ne nje kryqezim rruges qe eshte nje aks national dhe ku fluksi i qarkullimit eshte mjaft i madh

KORNIZA INSTITUCIONALE: STATUSI I MBROJTJES, MENAXHIMI DHE FINANCIMI

STATUSI I MBROJTJES

A ka monumenti ndonjë status mbrojtjeje? Nëse po, ju lutem specifikoni atë.

Te gjithë monumentet jane pjese ne mirembajtje te bashkive perkatese, por nuk ka nje urdher specifik ne lidhje urdherin e mbrojtjes.

Nëse monumenti është i mbrojtur, ju lutem tregoni nga cili vit është mbrojtur.

Nisur nga fakti qe nuk ka nje urdher specifik mbrojtjeje, nuk ka nje vit te cilit t'i referohemi

Cili institucion është përgjegjës për mbrojtjen e tij?

Si per mbrojtjen ashtu edhe per mirembajtjen , pergjegjes eshte bashkia e Shkodres dhe njesia administrative Rrethina.

MENAXHIMI DHE FINANCIMI

Cili institucion është përgjegjës për menaxhimin e monumentit apo të kompleksit?

Te gjithë lapidaret janë nën përgjegjësi të bashkiave dhe njësive administrative përkatëse

A ekziston një plan menaxhimi për monumentin? Nëse po, ju lutemi jepni informacionin bazë (periudhën e vlefshmërisë etj.).

Nuk ka asnjë plan menaxhimi në lidhje me mbrojtjen apo mirëmbajtjen.

A ka raporte monitorimi lidhur me mbrojtjen apo menaxhimin e monumentit? Nëse po, ju lutemi tregoni se kush i përgatit ato, kujt i dorëzohen dhe për çfarë periudhe kohore përgatiten ato?

Duke mos pasur nderhyrje restauruese në objekt nuk ka pasur as raporte monitorimi në lidhje me mbrojtjen apo mirëmbajtjen.

A ka institucioni përgjegjës për menaxhimin ose kujdesin e monumentit buxhet të caktuar për mbrojtjen apo menaxhimin e tij? Nëse po, cila është shuma e buxhetit?

Në dijeni tone, nga interesimi në institucionet përkatëse, nuk ka fonde apo buxhet specifik për mbrojtjen e monumentit

A ka ndonjë informatë rreth shpenzimeve aktuale për mirëmbajtje, mbrojtje apo restaurim të monumentit?

Pas vendosjes së fundit në pozicionin aktual, nderhyrjet restauruese janë të tipit pastrim nga vegetacioni apo pastrim i ambjentit përreth, të cilat bëhen nga punonjësit e institucionit të cilin e ka nën mbikqyrje dhe si e tillë nuk janë një preventim në lidhje me këto punime.

A ka ndonjë informatë rreth shumës së të ardhurave totale që rrjedhin nga përdorimi i monumentit (përfshirë donacionet etj.)?

Nuk kemi arritur të gjejmë një informacion në lidhje me këtë informacion pasi është një aks nacional shumë i rrahur nga turistët dhe vendas.

VIZITAT, OFERTAT DHE PERCEPTIMET TURISTIKE

A ka informacion rreth numrit vjetor të vizitorëve në kompleks? Nëse po, ju lutemi jepni informacionin dhe burimet e informacionit.

Duke mos pasur një biletari nuk është e mundur përcaktimi i saktë i numrit të turistëve.

A ka informacion rreth strukturës së vizitorëve? Nëse po, ju lutemi jepni informacionin dhe burimet e informacionit.

Turistet jane te te gjithë llojeve kjo per shkakun se ai monument vizitohet jo vetem nga ato qe jane te interesuar ta shofin ate por edhe nga shume turiste te cilet udhetojne drejt vendeve te tjera permes rruges nacionale Shkoder- Han i Hotit

A është hyrja në kompleks me pagesë? Nëse po, ju lutemi tregoni se sa?

Nuk ka asnje pagese per te vizituar monumentin.

A ka sezoni turistik aktual ndonjë karakter të veçantë sezonal? Nëse po, ju lutem specifikoni se cilat periudha i mbulon.

Ne menyre te vecanti monumenti vizitohet nga persona te interesuar , veterane lufte apo anetare te LANÇ , ne ditet kur ato bejne homazhe prane monumentit.

A ekziston aktualisht ndonjë ofertë turistike e përcaktuar për monumentin e përmendur? Nëse po, ju lutemi përshkruani atë duke specifikuar se çfarë përfshin, kush e siguron atë, për cilat grupe të synuara dedikohet dhe jepni një vegëz me informacionet shtesë.

Ne dijeni tone nuk ka nje guide konkrete qe e pjese te guides turistike edhe kete destinacion

Bazuar në analizën e kryer të platformave online dhe rrjeteve sociale (Foursquare, TripAdvisor, Airbnb, Facebook, Instagram, etj.), cila është përshtypja e vizitorëve ndaj monumentit? (Ju lutemi shënoni fjalët kyçe që i kanë përmendur, komentet kryesore pozitive dhe negative, se si i përdorin hashtag-et etj.).

Numri i turisteve qe e permendin ne platformat apo rrjetet sociale nuk eshte shume i madh ne vendoshjen e sotme. Nga kerkimet ne internet na rezulton se ky monument ka pasur me shume impakt viziv kur ka qene i vendosur ne qendren e qytetit.

Sipas mendimit tuaj, cili lloj i turizmit do të ishte optimal për këtë monument? Ju lutemi përshkruani shkurtimisht.


Nisur nga historia e 5 heronjve te gjithë ato turiste qe jane te apasionuar pas historise, sakrifies dhe vetflijimit jane te interesuar te shikojne nga afer. Por specifikisht per kete monument mendojme se target grupi i interesuar jane artistet dhe me konkretisht skulptoret. Ky monument eshte i pari ne llojin e tij ne veriun e Shqiperise , ne lidhje me luften Nacional Clirimtare, per nga lartesia dhe volumi i derdhur ne bronx. Gjithashtu eshte i vecante per faktin e perdorimit te 5 figurave njekohesisht.

INFRASTRUKTURA E TURIZMIT

A ka vend-parking afër monumentit për vetura private, biçikleta dhe autobusë? Ju lutemi përshkruani atë. Ju lutemi tregoni distancën e tij nga kompleksi.

Per vete faktin se eshte vendosur nje kryqezim rruges nuk ka vende parkimi specifik per monumentin. ne distance 15 m nga monumenti ka nje parkim qe eshte i biznesit me te afert ne lidhje me monumentin.

<https://www.google.com/maps/place/5+Heronjt%C3%AB+e+Vigut+.%5B+Alb%C3%A1n+h%C5%91s+.%5B+@42.0890395,19.5074509,164m/data=!3m1!1e3!4m5!3m4!1s0x134e0091b9901f59:0xdea7ce15d4816c1!8m2!3d42.0893108!4d19.5073943>



A është qasja në monument e projektuar mirë dhe e sigurt? Ju lutemi përshkruani.

Nuk mund te themi se aksesimi eshte i sigurte sepse per te arritur tek monumenti duhet kaluar rruga kryesore, dhe per me teper nuk ka vendqendrim tek monumenti qe te mund ta vizitosh.

A ka qasje për vizitorët me aftësi të kufizuara në monument, p.sh. në të gjitha zonat e qasshme për turistët e tjerë? Ju lutemi përshkruani.

Aksesi per persona me aftesi te kufizuar nuk eshte i pershtatshem per vete faktin se pozicionohet ne rruge.

A ka tualete në kompleks? Ju lutemi tregoni distancën e tyre nga monumenti dhe nëse gjendja e tyre është e kënaqshme ose e pakënaqshme (gjendja fizike, mirëmbajtja...).

Nuk ka nyje higjenosanitare publike ne zonen perreth. Te tilla nevoja mund te plotesohen vetem tek bizneset perreth te cilat kane nyje sanitare.

A është kompleksi i pajisur me mobilar urbane, stola/ulëse, kosha për mbeturina etj. Ju lutemi përshkruani.

Ne rrethin ku eshte vendosur monumenti ka vetem gjelberim dhe nuk ka asnje element tjetër te arredimit urban

A është kompleksi i pajisur me infografikë, shenja, mbishkrime etj. në gjuhë të ndryshme? Ju lutemi përshkruani.

Jo, nuk kemi vene re asnje tabele informuese

A ka ndonjë burim të ujit të pijshëm në kompleks ose në afërsi të tij (ju lutemi shënoni se ku)? Ju lutemi përshkruani nëse ai është burim i natyrshëm i ujit, nëse ndodhet brenda një ndërtese etj.

Nuk ka asnje burim natyror uji ne afersi te monumentit, por ne afersi te monumentit ka biznese te cilet kane uje te pijshem.

A ka ndriçim në kompleks? Ju lutemi përshkruani.

Ndricimi i monumentit naten vjen vetem nga ndricimi rrugor

A ka kompleksi mbulueshmëri nga ndonjë rrjet celular, WI-FI etj.?

Po, ka mbulim nga rrjetet telefonike qe operojne ne Shqiperi

Në çfarë distance nga kompleksi mund të gjendet ndonjë kafene, restorant dhe vend për akomodim?

Ne nje rreze 500m nga objekti mund te gjesh restorant, bar, kafe, hotel ne varesi te nevojave te turistit

GRUPET E INTERESIT

- Bashkia Shkoder
- Njesia Administrative Rrethina

Deklarata mbi mohimin e përgjegjësisë: Ky dokument “Vlerësimi i monumenteve të kushtuara Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri për formimin e prodhimit të ri turistik rajonal/rutës kulturore në Evropën Juglindore” është hartuar me asistencë të grantit të siguruar përmes Projektit për zhvillim dhe promovim të turizmit të Këshillit për bashkëpunim rajonal, të cilin e financon Bashkimi Evropian. Përmbajtja e këtij dokumenti “Vlerësimi i monumenteve të kushtuara Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri për formimin e prodhimit të ri turistik rajonal/rutës kulturore në Evropën Juglindore” është përgjegjësi ekskluzive e EXPEDITIO dhe nuk i shpreh doemos qëndrimet e Këshillit për bashkëpunim rajonal ose të Bashkimit Evropian.